



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## KOMUNA KLINË

### Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

05 Nr. 060 - 23983/23  
Klinë, datë: 20.07.2023

## PROCESVERBAL

Nga Debatit me Publikun në fshatin Jashanicë, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “TRE DËSHMORËT”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Pogradjë, Resnik dhe Jelloc. Tubimi u mbajt me datë 16 qershor 2023 dhe filloi në orën 17:00, ku morën pjesë: 9 persona.

## RENDI I DITES

### 1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave ka bërë një prezantim për shifrat që do ti këtë buxheti për vitin 2024. Ai gjithashtu prezantoi edhe objektivat kryesore të Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026 e që janë Zhvillimi Ekonomik, Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale, e cila paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës, zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve si dhe projektet me prioritet për vitin 2024.

Kryetari Elezaj me një fjalë rasti gjatë hapjes së këtij takim falënderoi banorët për kontributin e dhënë në vitin e kaluar në takime të tillë publike buxhetore me ç ‘rast ata kanë arritur të shtyjnë përpëra një projekt të rëndësishme të këtyre zonave dhe i cili pritet të realizohet brenda këtij viti pasi edhe kontrata me operatorin ekonomik tashmë është finalizuar. Ndërsa, sivjet në Jashanicë, Pogradjë, Resnik dhe Jelloc i kemi të planifikuar mbi 230 mijë euro për asfaltimin e rrugëve lokale, shtrirjen e kanalizimit si dhe ndërtimin e kanalit të betonit.

## DISKUTIMET DHE KËRKESAT

**Masar Marmallaku – Fshati Dush**, kërkesë për shtrimin e një rrugice 70 metra në fshatin Dush, lagjja “Sejdiu”, po ashtu kërkon të bëhet ndriçimi publik në fshatin Dush.

**Isni Bajraktari – Fshati Resnik**, pyet se kur do të bëhet pastrimi i kanalit nga reshjet e shiut sepse kanalet janë të ngulfatur me mbeturina dhe baltë.

**Kryetari Elezaj** përgjigjet, se në projektet e planifikuara për vitin 2024 do të parashihen edhe pastrimet e kanaleve ujore dhe përroksat, për të ndihmuar në akumulimin e ujërave nga të reshurat. Po ashtu, shprehet se vërshimet janë një sfidë për rajonin e Klinës, sidomos përgjatë lumenjve, ku thekson se janë përqendruar projekte infrastrukturore të mëdha.



**Liridon Racaj – Fshati Jelloc**, kërkon zgjerimin e shtrirjes së ujit të pijes në fshatin Jelloc dhe Resnik.

**Kryetari Elezaj** përgjigjet se projekt i do të merr kohë deri në finalizimin final, sepse fshatrat përreth janë duke u kompletuar me ujësjellës. Ky projekt parashihet të bëhet me “Hidrodrinin” dhe në planifikimin afatshkurtër “Hidrodrini” ka premtuar se Jeloci do të përfshihet në ujë të pijshëm.

Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “TRE DËSHMORËT”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afér Pogragjë, Resnik dhe Jelloc, pjesëmarrës kanë qenë 9 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	1
Meshkuj	8
Total:	9

Takimi përfundoi në orën 17:35.

Procesmbajtësi:

Nikson Daka

Klinë, datë: 20.07.2014

